

J.M. - 1 Maji shqiptar

Contributed by jozef martini
Friday, 01 May 2015

1 Maji shqiptar

J.M.

1 Maji shqiptar

J.M.

Sa here vjen 1 maji shqiptarët i drejtohen qofteve e rakisë e ne shtyp bahen të njajtat komente. Çuditën e sillen me gjetë shkakun se pse shqiptarët e konsiderojnë veç si ditë pushimit e piknikut e jo ditë përpjekjesh për të drejtat e punëtorëve si pjesa tjetër e botës.

Arsyeja asht krejt e thjeshtë. Në Shqipni nuk kishte klasë punëtore e si rrjedhojë as lëvizje të tyne për te drejta atherë kur filluen betejat ne USA e Europë e as ma vonë kur veç u sajuen disa rrena per me justifikue “revolucionin” e pandodhun. Si datë e veçantë në kalendar imponohet ma vonë prej partisë që kishte marrë edhe emnin Partia e Punës, si festa kryesore e Shqipnisë, bash për me justifikue ekzistencën, pushtetin diktatorial dhe dhunën e saj.

Pra, 1 Maji hyn fuqishëm në Shqipni qysh në fillim i shtrembnuem. Hyn jo si shtymje e vetëdijëshme, por si i imponuem në një realitet, pa pasë as ma të voglën lidhje me zhvillimin social të shqiptarëve. Hyn jo vetëm si huazim i pakuptimtë për nivelin e Shqipnisë, por, çka asht ma e keqja, hyn edhe si rrenë. Prandaj s’arrin me krijue asnjë lidhje shpirtnore të vërtetë me shqiptarët (përveç ditës kur parakalohej e brohoritej para tribunës së udhëheqësit dje, kurse sot ditës kur rrihet pa punë, dilet me shetitë e në Tiranë pihet ndonji birrë kodrave të liqenit).

Kjo lloj hymjet e forcueme në këtë mënyrë në Shqipni ia përcaktoi edhe karakterin si “festë”. Në rrenat e kohës realiteti paraqitet i tillë: “klasa” punëtore kishte marrë pushtetin në dorë e udhëhiqte vendin, kishte krye revolucionin e tash gëzonte ditët e lumtuna. Ky ishte versioni zyrtar, dalja kundër të cilit të çonte në burg a pushkatim si armik. Si rrjedhojë nuk kishte beteja për të drejta me fitue, sepse ishin arritë tashma (betejat do të ishin quejt veprim antirevolucionar i dënueshëm me masa ekstreme). Në versionin e PPSH shqiptarët nuk jetonin në realitetin e përpjekjes për të drejta, por në atë ku të drejtat ishin fitue përfundimisht, pra s’kishte vend për beteja, por për festë. Punëtorëve s’u mbetej tjetër veç me iu gëzue arritjes së lumtunisë e me përqaftue e falenderue “bamirësin” paradave ku nxirreshin me zor.

Aty iu vue vula si festiv e jo si rrugë përpjekjesh e si i tillë vazhdon edhe sot kur punëtorët s’kanë asgja pse me protestue, asgja për me kërkue si të veten, anji të drejtë të lindun (ndërkohë që Partia “e majtë”, ajo që deri dje quhej e Punës, në një qeverisje “të majtë”, fton financuesit e huej tue shpallë me hare se asht e leverdisëshme me investue në tregun e punës në Shqipni, sepse punëtorët shqiptarë s’kane sindakata për me i mbrojtë).

Ky asht 1 Maji shqiptar. Tregues i nivelit të ulët të zhvillimit shoqnor. I huazuem pa kuptimin origjinal. I përcjellun rrejshëm si celebrativ i fitores përfundimtare e i arritjes së lumtunisë gjatë diktaturës komuniste. I vazhduem si i pakuptimtë në një shoqni pa asnjë ideal a pa asnjë forcë të brendëshme reaguese dhe tregues i hipokrizisë së partive që quhen të majta.

(Giuseppe Pellizza da Volpedo, “Il Quarto Stato”, 1901.)

